

Thirrje për kompani, OJQ apo individë për të ofruar konsulencë në realizimin e katër planeve të punës për edukim dhe promovim shëndetësor në katër komuna.

Përshkrimi i detyrave të punës

Pozita	Konsulent për hartimin e planeve të punës për edukim dhe promovim shëndetësor në komunat Fushë Kosovë, Gjiilan, Lipjan dhe Gjakovë.
Numri i ditëve të punës	16 ditë pune
Periudha e angazhimit	Nëntor 2021 – Mars 2022

Sfondi

Sipas të dhënave të Anketës së Treguesve të Shumfishtë (MICS) 2019-2020, vetëm 73 përqind e fëmijëve të moshës dy vjeçare në Kosovë janë të imunizuar plotësisht. Ndërkaq, përqindja e fëmijëve Romë, Ashkali, dhe Egjiptianë të imunizuar plotësisht është edhe më e vogël – vetëm 38 përqind. Mungesa e ndërgjegjësimit mbi rëndësinë e imunizimit të rregullt dhe gjendja e pafavorshme ekonomike konsiderohen dy nga faktorët kryesorë që ndikojnë në shkallën e ulët të imunizimit të fëmijëve Romë, Ashkali dhe Egjiptianë në Kosovë.

Me qëllim të rritjes së shkallës së imunizimit, me theks të veçantë në komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian, si dhe të rritjes së ndërgjegjësimit të prindërve dhe kujdestarëve mbi rëndësinë e imunizimit të rregullt, Balkan Sunflowers Kosova është duke implementuar projektin për rritjen e qasjes dhe mbulueshmërisë me vaksinat e rregullta, të mbështetur nga Zyra e UNICEF-it në Kosovë. Projekti synon mbështetjen e institucioneve të kujdesit parësor shëndetësor në organizimin e sesioneve të imunizimit, ndërgjegjësimin dhe aktivitetet edukative për prindërit, kujdestarët, punonjësit shëndetësorë, dhe vullnetarët e rinj, përfshirë trajnimin për aftësitë e komunikimit ndërpersonal për imunizimin.

Qëllimi i angazhimit

Balkan Sunflowers Kosova është duke kërkuar një konsulent për të asistuar Komitetet për Edukim dhe Promovim Shëndetësor në katër komuna për hartimin e planeve të punës për edukim dhe promovim shëndetësor, me fokus të veçantë rritjen e shkallës së imunizimit të rregullt në këto komuna. Komunat ku konsulencia kërkohet janë Fushë Kosova, Gjiilani, Lipjani dhe Gjakova.

Konsulenti duhet të analizojë materialet ekzistuese për edukim dhe promovim shëndetësor dhe në bashkëpunim me anëtarët e komiteteve komunale për edukim dhe promovim shëndetësor të hartojë planet të punës për katër komitetet. Planet tri-vjeçare

të punës duhet të hartohen bazuar në rezultatet e punëtorive që do të organizohen me Komitetet në fjalë, dhe të cilat do të fasiltohen nga konsulenti. Konsulenti duhet të mbajë së paku dy punëtori në secilën komunë të përzgjedhur. BSFK do të asistojë konsulentin në organizimin e tetë punëtorive njëditore në katër komunat e përzgjedura. Pjesëmarrës në takim do të janë anëtarët e komiteteve komunale për edukim dhe promovim shëndetësor, OJQ-të që merren me shëndetësi, dhe mund të ftohen edhe akterë të tjerë të cilët propozohen nga komiteti apo konsulenti.

Konsulenti ka në dispozicion tetë ditë tjera për të analizuar të dhënat e marra nga punëtoritë dhe të përshkruaj planin e punës për katër komitetet komunale.

Lokacioni i trajnimeve do të caktohet nga BSFK dhe konsulenti do të lajmërohet nga BSFK së paku tri ditë para organizimit të punëtorisë.

Konsulenti mund të koordinohet me BSFK për shfrytëzimin e paisjeve dhe poashtu transportit lidhur me implementimin e punëtorive.

Balkan Sunflowers Kosova (BSFK) do të merret me organizimin e çeshtjeve logjistike dhe teknike të mbajtjes së punëtorive (hapësirat, ftesat, agjendat, materialet, ushqimin, etj). Konsulenti në bashkëpunim me BSFK dhe UNICEF do ta dizajnon agjendën e trajnimit.

Konsulenti duhet ta përgatis materialin i cili mund të përdoret në punëtori dhe dërgojë te BSFK së paku dy ditë para ditë së punëtorisë që të printohet me kohë.

Konsulenti duhet të sigurojë që materiali i përdorur dhe prodhuar nuk kanë konflikt interesi me korinzën ligjore ose me të drejtat e njeriut.

Konsulenti duhet të respektoj kornizën ligjore dhe politikat për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe politikat për parandalim të eksploatimit dhe abuzimit të femrave dhe të miturve.

Përshkrimi i hollësishëm i detyrave të punës

Qëllimi i angazhimit të konsulentit është ofrimi i ekspertizës për hartimin e planeve të punës për edukim dhe promovim shëndetsor në komunat Fushë Kosovë, Gjiilan, Lipjan dhe Gjakovë. Angazhimi përfshin aktivitetet në vijim:

- Përgatitja e planit të punës;
- Analiza e materialit ekzistues lidhur me edukim dhe promovim shëndetësor;
- Në bashkëpunim me BSFK përcakton datat dhe përgatit agjendën e punëtorive;
- Përgatitja dhe fasiltimi i tetë punëtorive (dy në secilën komunë të përzgjedhur) për caktimin e objektivave dhe aktiviteteve të planeve të punës;
- Komunikimi i rregullt me ekipin punues dhe palët tjera me qëllim të mbledhjes dhe verifikimit të dhënave të nevojshme;

- Zhvillimi i planeve të punës për katër komuna;
- Dërgimi i drafteve finale të planeve të punës në zyre të BSFK;

Kushtet e angazhimit

- 16 ditë pune.
- Data e fillimit të angazhimit 15 Nentor 2021 dhe përfundon me 31 Mars 2022

Kualifikimet

Kompania ose OJQ duhet:

- Të jetë e regjistruar në Kosovë;
- Të ketë përvojë minimale prej 2 vjetësh në fushën e objektivave të thirrjes.
- Përvoja e mëparshme e punës.

Individët duhet të:

- Dërgojnë CV e cila përshkruan përvojën e punës në lamin e kërkuar në këtë thirrje.
- Dëshmojnë që kanë kapacitet për të përfunduar punën.
- Ofrojnë referenca për punë të ngjajshme.
- Posedojnë dokumente valide për të lidhur kontratë angazhimi

Palët e interesuara duhet të dërgojnë këto dokumente:

- Shembuj nga materialet apo grafitet e zhvilluara.
- Planin e punës (mënyrë elektronike).
- Çmimin e ofertes.

Afati i aplikimit:

Kompanitë e interesuara duhet të dërgojnë dokumentet e tyre të aplikimit (të përmendura më lartë) në emailin: applications@balkansunflowers.org

Afati I fundit për dërgimin e ofertave është 19 Nëntor 2021 ora 15:00

Për çdo pyetje teknike që lidhet me kërkesën tuaj, ju lutemi na kontaktoni në:

office@balkansunflowers.org